

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6070
E enjte, 23 korrik 2020
çmimi 0.40 €

Rritet numri i të infektuarve me Covid-19, 241 raste të reja vetëm në 24 orët e fundit



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHXHET SHALA

PA OPOZITËN NUK KA MARRËVESHJE ME SERBINË



Analisti politik Behxhet Shala ka thënë se pa opozitën nuk mund të ketë marrëveshje përfundimtare Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se nuk mund të synohet një marrëveshje e tillë duke anashkaluar 54 deputetë shqiptarë të Lëvizjes Vetëvendosje dhe të Partisë Demokratike të Kosovës. Shala ka vlerësuar se për shkak të interesit nacional, subjektet politike duhet të arrijnë një konsensus rreth procesit të dialogut me Serbinë. Sipas tij, bashkimi i subjekteve politike për këtë çështje do të ndikonte edhe në cilësinë e marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi

NJË GRUP I VOGËL I QYTETARËVE KANË PROTESTUAR KUNDËR NDËRTIMIT TË XHAMISË SË MADHE NË PRISHTINË

SHUMICA E QYTETARËVE JANË PËR NDËRTIMIN E XHAMISË SË MADHE NË PRISHTINË



Një grup i vogël i qytetarëve të mërkurën kanë protestuar në lagjen "Dardania" kundër ndërtimit të Xhamisë së Madhe në Prishtinë. Në këtë protestë ka pasur mospajtime në mes të dy grupeve të

protestuesve, një pjesë e protestuesve kanë kundërshtuar ndërtimin e kësaj xhamie, kurse një pjesë tjetër e qytetarëve kanë thënë se xhamia duhet të ndërtohet. Përkrahje ndërtimit të kësaj xhamie

të mërkurën i kanë dhënë presidenti Hashim Thaçi dhe kryetari i LDK-së, Isa Mustafa. Sipas një sondazhi të fundit, 84 për qind e qytetarëve e përkrahin ndërtimin e Xhamisë së Madhe në Prishtinë

Mundësohet tërheqja e 10-përqindëshit nga Fondi Pensional

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION

EDHE NJË HERË NJË KUJTESË MBI VLERAT E UÇK-së DHE TË LUFTËS QË MBARTI AJO (14)

F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTUALE



OVLUÇ-ja KËRKON SHKARKIMIN E EURODEPUTETES VIOLA VON CRAMON F. 3

TOMMASO VITALE: NUK KA NDRYSHIM NË MANDATIN E KFOR-it NË KOSOVË F. 2

MINISTRI QUNI THOTË SE FSK-ja PO PËRGATITET TË JETË GARANTUESE E SOVRANITETIT TË KOSOVËS F. 3

EKONOMI

XHEMAJLI: QEVERIA TA PARANDALOJË SHITJEN E IPKO-s TE TELEKOM SERBIA F. 8

SHOQATA E INVALIDËVE E LUFTËS E UÇK-së U JEP PËRKRAHJE PRIORITETEVE TË MINISTRIT REÇICA F. 8

SPORT

GJILANI NDAHET BARAS ME BALLKANIN, DRITA SHPALLET KAMPIONE F. 16

Tommaso Vitale: Nuk ka ndryshim në mandatin e KFOR-it në Kosovë



PRISHTINË, 22 KORRIK - Gjenerali i brigadës Ushtarake të NATO-s për lidhje në Beograd, ka deklaruar që nuk ka ndryshime në mandatin e KFOR-it në Kosovë. Ai ka shtuar se KFOR-i po e përmbushë "atë që është e përshkruar me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara". "Detyra jonë

është që t'i mbrojmë të gjithë njerëzit në Kosovë, që ta garantojmë lëvizjen e lirë për të gjithë dhe dëshiroj të them se në të njëjtën kohë e mbështesim fuqishëm rinisjen e dialogut (ndërmjet Kosovës dhe Serbisë) nën ombrellën e Bashkimit Evropian (BE) apo cilitdo aktor tjetër ndërkombëtar në mënyrë që ta tejkalojmë mosmarrëveshjen historike",

ka theksuar Vitale në panelin kushtuar bashkëpunimit të Serbisë dhe NATO-s në kuadër të javës së 8 të NATO-s që po mbahet në Beograd, nën organizimin e organizatës joqeveritare Qendra për Studime Euroatlantike. Ai ka thënë se KFOR-i ka qenë, është dhe vazhdon të jetë plotësisht i përkushtuar dhe, sipas tij, nuk do të ketë ulje të numrit të trupave.

Rritet numri i të infektuarve me Covid-19, 241 raste të reja vetëm në 24 orët e fundit

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 KORRIK - Krahasuar me trendin pozitiv të ditëve të fundit të rënies së rasteve me Covid-19, të mërkurën është shënuar numri më i madh i infektuarve me koronavirus që nga rasti i parë i paraqitur në muajin mars të këtij viti. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit në vendin tonë janë paraqitur 241 raste të reja me Covid-19. Po ashtu, ky institut ka bërë me dije se betejën me Covid e kanë humbur edhe gjashtë persona dhe janë shëruar 143 të tjerë. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 419 mostra të marra nga ShShKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 241 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 6 286 raste nga 32 375 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, me gjithsej

150 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 143 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 3 369 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2762", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se nga 241 rastet e reja, Prishtina prin me 86 të infektuar me virusin korona. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 86 raste, komuna Gjilan 21 raste, komuna Ferizaj 17 raste, komuna Podujevë 13 raste, komuna Viti 12 raste, komuna Mitrovicë 9 raste, komuna Vushtrri 9 raste, komuna Gjakovë 9 raste, komuna Fushë Kosovë 8 raste, komuna Kamenicë 8 raste, komuna Lipjan 8 raste, komuna Prizren 8 raste, komuna Rahovec 6 raste, komuna Obiliq 4 raste, komuna Drenas 3 raste, komuna Kaçanik 3 raste, komuna Klinë 3 raste, komuna Shtime 3 raste, kurse nga 2 raste komunat: Pejë, Malishevë Skenderaj, Suharekë dhe nga 1 rast Deçan, Zubin Potok dhe Dragash", ka njoftuar ky institut. Më tutje, IKShPK-ja ka përsëritur




thirrjen bërë qytetarëve, duke kërkuar nga ta që t'i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19. "Të nderuar qytetarë, virusi është kudo. Ju lutemi përmbahuni rekomandimeve. Virus i vret! Zbatimin e rekomandimeve të Institutit

Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë duhet ta bëjë çdo qytetar i Republikës së Kosovës që të ruajë veten, të afërmit dhe të tjerët. Bartja e maskave mbetet obliguese. Apelojmë te qytetarët, bizneset, gastronomia, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe

ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura", ka njoftuar IKShPK-ja. Sipas këtij instituti, çdo shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve.

Interpoli konfiskon 17 000 teste false të koronavirusit

LYON, 22 KORRIK - Agjencia Ndërkombëtare e Policisë, Interpol, njoftoi se ka konfiskuar 17 000 teste false për koronavirus në një operacion të gjerë ndërkombëtar kundër kontrabandës së pijeve, ushqimeve dhe produkteve mjekësore potencialisht të rrezikshme. Në operacionin që është zhvilluar në periudhën dhjetor 2019 - qershor 2020 nga Interpoli dhe Agjencia Evropiane e Policisë, EUROPOL, në 77 vende janë kapur mbi 12 000 tonelata mallra, në vlerë prej 40 milionë dollarësh, thuhet në njoftim. Po sipas kësaj agjencie, 19 organizata kriminale



janë shpërbërë dhe 407 persona janë arrestuar. Përveç testeve të rreme për koron-

avirus, janë konfiskuar edhe produkte të kontaminuara të qumështit, mish nga kafshë

të vrara në mënyrë të paligjshme dhe produkte false mjekësore. Në Bullgari është zbuluar një depo me djathë të infektuar me bakterin E.Coli, ndërsa në Jordani janë kapur 6 500 litra pije energjike me afat të skaduar dhe mbi shtatë tonelata qumësht dhe djathë i prishur. Në Afrikën e Jugut, një dërgesë nga Azia, që supozohet se kishte pajisje mbrojtëse mjekësore, kishte në të vërtetë fruta deti, ka njoftuar Interpol. "Në kohën kur po bëhen përpjekje në të gjithë botën për ta ndaluar koronavirusin, fakti që rrjetet kriminale shpërndajnë produkte

të tilla potencialisht të rrezikshme, tregon vendosmërinë e tyre për të përfituar", tha sekretari i përgjithshëm i Interpolit, Jurgen Stock. Alkooli i kontrabanduar përbën pjesën më të madhe të mallrave të konfiskuara dhe vlera e tij është më shumë se 20 milionë dollarë, ka njoftuar Interpol. Operacioni, i quajtur "Opson", i cili organizohet çdo vit tash e nëntë vjet, ka bërë të mundur edhe parandalimin e tregtisë me mallra të tjera të falsifikuara, si kozmetikë, veshje, duhan, këpucë dhe produkte elektronike, me vlerë totale prej 3.1 milionë dollarësh.

OVLUÇK-ja kërkon shkarkimin e eurodeputetes Viola Von Cramon

“Do të bëjmë një reagim për eurodeputeten Cramon sepse jemi të prekur nga sjellja e saj. Kjo ka kohë që ka humbur ekuilibrin politik që do të duhej ta kishte një raportuese për Kosovën. Përderisa e gjithë bota u çua në këmbë për shfuqizimin e Ligjit të Gjykatës Speciale, ajo një ditë pas intervistimit të presidentit pa fije turpi ka vizituar Gjykatën Speciale dhe vizita e saj ka qëllime specifike për këtë rast”, ka thënë kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 KORRIK - Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka kundërshtuar vizitën e raportueses për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, në Gjykatën Speciale në Hagë. Në një konferencë për media, udhëheqja e OVLUÇK-së konsideron se kjo vizitë lidhet pikërisht me intervistimin e presidentit Hashim Thaçi nga Dhomat e Specializuara të Gjykatës Speciale. “Ne do të bëjmë një reagim për eurodeputeten Cramon sepse jemi të prekur nga sjellja e saj. Kjo ka kohë që ka humbur ekuilibrin politik që do të duhej ta kishte një raportuese për Kosovën. Përderisa e gjithë bota u çua në këmbë për shfuqizimin e Ligjit të Gjykatës Speciale, ajo një ditë pas intervistimit të presidentit pa fije turpi ka vizituar Gjykatën Speciale dhe vizita e saj ka qëllime specifike për këtë rast”, ka thënë kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati. Ai ka kërkuar nga Parlamenti Evropian shkarkimin e Von Cramon, që t'i hiqet misioni si raportuese

për Kosovën. “Ne kërkojmë nga Parlamenti i Evropës shkarkimin e Von Cramon dhe t'i hiqet misioni si raportuese për Kosovë”, ka thënë Gucati. Edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar pas vizitës së raportueses për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon në

Hagë, një ditë pas intervistimit të presidentit Hashim Thaçi, duke e quajtur vizitën e të dyshimtë për pavarësi nga ndikimi politik. KMDLNj-ja përmes një njoftimi për media ka thënë se Viola von Cramon qartazi po ushtron ndikim politik në këtë veprim raportuesja për Kosovën Viola von Cramon qartazi po

ushtron ndikim politik në këtë gjykatë, aq më parë që edhe më herët ka ndërhyrë në punët e brendshme të Kosovës me anime flagrante politike. Për më tepër, e ashtuquajtura Gjykatë Kushtetuese e Dhomave të Specializuara dhe i ashtuquajtura Ombudsperson i këtyre Dhomave të Specializuara për ndarje të

drejtësisë sipas parimit etnik dhe duke mos siguruar drejtësi për pjesën dërrmuese të viktimave, ekskluzivisht për shkak të përkatësisë etnike po dëshmojnë se janë institucione koti, pa autoritet dhe kundër të drejtave të personave, tash të dyshuar dhe potencialisht të akuzuar”, thuhet në reagimin e KMDLNj-së.



Ministri Quni thotë se FSK-ja po përgatitet të jetë garantuese e sovranitetit të Kosovës

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 KORRIK - Në ambientet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ka raportuar të mërkurën në mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, për zhvillimet e përgjithshme të FSK-së, ku të pranishëm ishin edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, sekretari i përgjithshëm i MM-së, Faruk Geci, këshilltari ushtarak, kolonel Hamdi Pollomi dhe zyrtarja e lartë e kabinetit, Martina Dedaj-Kçira. Takimin e udhëhoqi kryetarja e këtij komisioni, Fatmire Kollçaku-Mulhaxha. Ministri Quni fillimisht i njoftoi anëtarët e Komisionit Parlamentar për Çështje të



Sigurisë dhe Mbrojtjes, për të arriturat dhe objektivat e përgjithshme të FSK-së. “Ministria e Mbrojtjes i ka objektivat e deklaruar që synon t'i arrijë gjatë këtij viti dhe në vitet e ardhshme. Objektivat për vitin 2020-2021 janë në shërbim të realizimit të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit,

ku përfshihen çështjet: strategji, politika, akte nënligjore, personelin, zhvillimin në karrierë, krijimin e njëjësive të reja, rikonstruktimit dhe riorganizimit të Ministrisë dhe FSK-së. Ky proces mbështet me të gjitha ato nevoja nga fusha e teknologjisë ushtarake që do të aplikohet brenda FSK-së dhe

këto së bashku kanë një dinamikë deri në vitin 2027, që çdo njësi veç e veç, por edhe FSK-ja në përgjithësi të shpallen të certifikuar me arritjen e kapaciteteve të plota operacionale”, ka thënë Quni. Në vazhdim ministri Quni shtoi se, pavarësisht prej situatës me pandeminë, operacionaliteti i

FSK-së është i tillë që të garantojë, që deri në vitin 2027 do të arrijë t'i deklarojë kapacitetet e plota, që FSK-ja të jetë garantuese e sovranitetit dhe integritetit të Kosovës, të jetë plotësisht e gatshme t'u përgjigjet nevojave të autoriteteve civile për asistencë dhe e gatshme të zbarkojë jashtë vendit në operacione paqeruajtëse. Ministri Quni ka shtuar se për çdo objektiv duhet angazhim i veçantë sepse kërkon dinamikë të diplomacisë së jashtme, ekspertizë të lartë të FSK-së dhe besueshmëri të komuniteti ndërkombëtar. Po ashtu, gjenerallejtënant Rrahman Rama i ka njoftuar të pranishmit me zhvillimet më të reja në planin e përgjithshëm të FSK-së, aktivitetet për realizimin e objektivave dhe planin gjithëpërfshirës të tranzicionit.

Flet për “Epokën e re”, Behxhet Shala

Pa opozitën nuk ka ma



Analisti politik Behxhet Shala ka thënë se pa opozitën nuk mund të ketë marrëveshje përfundimtare Kosovë - Serbi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka theksuar se nuk mund të synohet një marrëveshje e tillë duke anashkaluar 54 deputetë shqiptarë të Lëvizjes Vetëvendosje dhe të Partisë Demokratike të Kosovës. Shala ka vlerësuar se për shkak të interesit nacional, subjektet politike duhet të arrijnë një konsensus rreth procesit të dialogut me Serbinë. Sipas tij, bashkimi i subjekteve politike për këtë çështje do të ndikonte edhe në cilësinë e marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 22 KORRIK - Analisti politik Behxhet Shala ka bërë me dije se marrëveshja finale me Serbinë nuk mund të arrihet pa Lëvizjen Vetëvendosje dhe Partinë Demokratike të Kosovës. Ai ka thënë se me përbërjen aktuale koalicioni qeverisës nuk ka fuqi politike dhe numerike për ta arritur marrëveshjen me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën “Epoka e re”, Shala ka deklaruar se nuk mund të merret asnjë vendim i një rëndësie të veçantë për Kosovën duke lënë anash 54

deputetë shqiptarë. “Është e pamundur që të bëhet dialogu pa një konsensus të partive më të mëdha shqiptare. Pra, është e pamundur të vazhdojë dialogu i Brukselit dhe të arrihet një marrëveshje duke e lënë jashtë këtij procesi LV-në dhe PDK-në që kanë 54 deputetë shqiptarë. Në këto kushte nuk mund të merret asnjë vendim i një rëndësie të veçantë për Kosovën”, ka thënë ai.

Shala ka deklaruar se për hir të interesit kombëtar subjektet politike duhet të arrijnë një konsensus rreth procesit të dialogut me Serbinë. Sipas tij, nëse do të ndodhte bashkimi i

subjekteve politike për këtë çështje, kjo do të ndikonte edhe në cilësinë e marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi. “Për shkak të interesit kombëtar dhe shtetëror është mirë që subjektet më të mëdha politike në vend, LV-ja, LDK-ja, PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma të bashkohen për këtë çështje. Në këtë mënyrë këta ta kenë fjalën përfundimtare në dialogun Kosovë - Serbi. Kjo do të ishte në të mirë të Kosovës sepse, edhe nëse do ta kundërshtonin marrëveshjen, kundërshtimi do të ishte më i fuqishëm dhe faktori ndërkombëtar do ta merrte shumë më seriozisht kundërshtimin e Kosovës”, ka

thënë Shala.

Ai ka folur edhe për mundësinë e mbështetjes së këtij procesi nga PDK-ja. Sipas Shalës, kjo do të varet nga epilogu i akuzave të Speciales ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. “Nëse aktakuza konfirmohet, situata do të ndryshojë rrënjësisht. Atëherë domosdoshmërisht do të bëhet një ridizajnim i skenës politike të Kosovës. Pra, do të kemi një situatë që edhe PDK-ja do të përfshihet në qeveri dhe do të bëhet pjesë e dialogut. Nuk ka kuptim që PDK-ja ta përkrahë marrëveshjen me Serbinë duke qëndruar në opozitë”, ka deklaruar Shala.

“Epoka e re”: Z. Shala, Qeveria e Kosovës ka rifilluar dialogun me Serbinë? Si e shihni vazhdimin e këtij procesi pa mbështetjen e opozitës?

Shala: Është e pamundur të bëhet dialogu pa një konsensus të partive më të mëdha shqiptare. Pra, është e pamundur të vazhdojë dialogu i Brukselit dhe të arrihet një marrëveshje duke e lënë jashtë

këtij procesi LV-në dhe PDK-në, që kanë 54 deputetë shqiptarë. Në këto kushte nuk mund të merret asnjë vendim i një rëndësie të veçantë për Kosovën. Nëse këto parti do të bëheshin pjesë e dialogut, kjo do të mund të ndikonte edhe në cilësinë e marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi dhe më pas edhe do të votohej në Kuvendin e Kosovës. Ndryshe nuk mund të kalojë asnjë marrëveshje në Kuvend përderisa janë në opozitë LV-ja dhe PDK-ja. Në këtë proces presidenti është nxjerrë nga loja qëllimisht prej Gjykatës Speciale dhe rolin kryesor në këtë proces e mori kryeministri Avdullah Hoti, i cili ka pak gjasa të përballet me Vuçiqin, i cili është një politikan i rryer, që ka përkrahje të madhe në Serbi dhe ndikim në arenën ndërkombëtare. Kurse Avdullah Hoti, përkundër vullnetit dhe dëshirës që ta përfaqësojë mirë Kosovën në këtë proces, ai nuk e ka konsensusin e brendshëm për ta vazhduar dialogun. Në këtë mënyrë është në një pozitë

Marrëveshje me Serbinë



“Epoka e re”: Mirëpo dy partitë opozitare nuk po bëhen pjesë e procesit, madje ato po i refuzojnë ftesat e kryeministrit për forumin e partive politike.

Shala: Lëvizja Vetëvendosje e ka një qëndrim për bisedime, por kjo parti ende ka hatërmbetje se pse ia kanë rrëzuar qeverinë, edhe vendorët, por edhe ndërkombëtarët. Ndërsa PDK-ja nuk ka ndonjë qëndrim të vendosur as për të mos u bërë pjesë e dialogu e as për t’u bërë pjesë e këtij procesi.

“Epoka e re”: Ky qëndrim i PDK-së, a nënkupton se mund të bëhet pjesë e koalicionit qeverisës?

Shala: Kjo krejt varet prej epilogut që do të ketë propozimaktakuza e Gjykatës Speciale ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. Nëse aktakuza konfirmohet, situata do të ndryshojë rrënjësisht. Atëherë domosdoshmërisht do

të bëhet një ridizajnim i skenës politike të Kosovës. Pra, do të kemi një situatë që edhe PDK-ja do të përfshihet në qeveri dhe do të bëhet pjesë e dialogut. Nuk ka kuptim që PDK-ja ta përkrahë marrëveshjen me Serbinë duke qëndruar në o p o z i t ë . Nëse kjo ndodh, atëherë edhe pa votat e LV-së mund të ratifikohet marrëveshja e mundshme me Serbinë. PDK-ja është në një pozitë që tash për tash më shumë ka nevojë LDK-ja për PDK-në sesa kjo fundit për LDK-së. Sepse LDK-ja me këtë koalicion qeverisës nuk mund ta arrijë asnjë marrëveshje, madje kemi parë që nuk po mund ta kalojë as buxhetin e lëre më ta ratifikojë ndonjë marrëveshje ndërkombëtare. Por, nëse PDK-ja dhe LV-ja bëjnë ndonjë marrëveshje në opozitë, shumë shpejt mund të kemi zgjedhje të reja. Mirëpo gjithë jemi

dëshmitarë që as faktori ndërkombëtar e as partitë e tjera në Kosovë nuk janë të gatshme për zgjedhje të reja. Sepse dihet që në zgjedhje do të fitonte LV-ja, por nuk do të fitonte sa po mendojnë ata.

“Epoka e re”: A do të ishte në rregull të arrihet marrëveshja finale me Serbinë duke anashkaluar partinë më të madhe në vend?

Shala: Kjo për mua nuk do të ishte normale, sepse nuk mund ta arrish një marrëveshje finale me Serbinë duke lënë anash 30 deputetë shqiptarë. Në anën tjetër, edhe LV-ja nuk duhet të këmbëngulë vetëm në qëndrimet e veta. Nëse kemi pranuar t’i bëjmë bisedimet me Serbinë, atëherë duhet ta bëjmë një ekip për të negociuar, i cili duhet të synojë që dëmet në këtë proces të jenë sa më të vogla dhe të mos preken sovraniteti dhe integriteti territorial i Kosovës.

“Epoka e re”: Në këtë situatë, si duhet të reagojnë institucionet dhe partitë politike në Kosovë?

Shala: Për shkak të interesit kombëtar dhe shtetëror është mirë që subjektet më të mëdha politike në vend, LV-ja, LDK-ja, PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma, të bashkohen për këtë çështje. Në këtë mënyrë këta ta kenë fjalën përfundimtare në dialogun Kosovë - Serbi. Kjo do të ishte në të mirë të Kosovës sepse edhe nëse do ta kundërshtonin marrëveshjen, kundërshtimi do të ishte më i fuqishëm dhe faktori ndërkombëtar do ta merrte shumë më seriozisht kundërshtimin e Kosovës. Me përbërjen aktuale të koalicionit qeverisës askush nuk do t’i marrë seriozisht në procesin e dialogut. Kështu që, është shumë vështirë të mendohet se me këtë përbërje mund ta arrihet marrëveshje me Serbinë e cila përcakton ardhmërinë dhe fatin e Kosovës.

Dhjetë vjet nga opinioni i GjND-së që vulosi pavarësinë e Kosovës

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 KORRIK - Të mërkurën u bënë dhjetë vjet qëkur Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë konstatoi se Deklarata e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, e shpallur më 17 shkurt 2008, është në përputhje me të Drejtën Ndërkombëtare. Me këtë rast, liderët shtetërorë dhe partiakë kanë theksuar se me këtë akt është vulosur përfundimisht subjektiviteti ndërkombëtar i shtetit të ri të Kosovës. “Sot u bënë 10 vjet kur u vulos përfundimisht subjektiviteti ndërkombëtar i shtetit të ri të Kosovës. Ne asnjëherë nuk kishim dyshime për të drejtën tonë historike, që të jetojmë të lirë në vendin tonë të pavarur dhe sovran. Serbia, pas humbjes së luftës në Kosovë, duke mos u pajtuar me këtë fakt, kishte vendosur ta dërgonte rastin e shpalljes së pavarësisë së shtetit tonë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ne, populli ynë, gjithmonë i kemi besuar drejtësisë ndërkombëtare, përkundër faktit që ende nuk kemi drejtësi për gjenocidin e shtetit të Serbisë të kryer mbi popullatën civile shqiptare në Kosovë. I kemi besuar dhe vazhdojmë t’i



besojmë drejtësisë ndërkombëtare, sepse gjithmonë ishim dhe vazhdojmë të jemi në të drejtën tonë”, ka thënë Thaçi. Edhe kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se me këtë akt përfundimisht është njohur subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës shtet i pavarur e sovran dhe është legjitimuar e drejta e popullit të Kosovës për pavarësi. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka vlerësuar se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë me mendimin këshillues për shpalljen e pavarësisë e ka pa pajisur Kosovën me një armë të rëndësishme në arenën ndërkombëtare. Ai ka thënë se

dështimi i Serbisë në GjND nuk u shfrytëzua nga Kosova. “Është për të ardhur keq që në këtë dekadë ky mendim i GjND-së më së shumti u përmend te fusnota që iu mbivendos emërtimit të Kosovës. Në vend se ta forcojë subjektivitetin tonë ndërkombëtar dhe shtetndërtimin e brendshëm, qeveria e atëhershme pat hyrë në dialog teknik e pastaj politik me Serbinë, gjithnjë për çështje të brendshme të Kosovës, duke e mbuluar rëndësinë e këtij vendimi dhe duke lejuar që të krijohet përshtypja se Kosova po rinegocion statusin e saj”, ka thënë Kurti.

Lideri i AAK-së, Ramush

Haradinaj, ka thënë se vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në favor të Republikës së Kosovës, përpos që legjitimoi procesin e shpalljes së pavarësisë, forcoi edhe Kosovën e 17 shkurtit. “I tërë angazhimi ynë është që këto dy vendime të rëndësishme historike të mos tjetërsohen me asnjë çmim”, ka thënë Haradinaj.

Kurse kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se vendimi i GjND-së mbetet ndër sukseset më të mëdha të shtetit tonë në arenën ndërkombëtare, duke vulosur kështu përpjekjet dhe aspiratat tona shekullore për Republikën e Kosovës.

krejtësisht të pafavorshme përballë Serbisë. Me publikimin e aktakuzës ndaj Thaçit dhe Veselit, Kosova është në pozitë krejtësisht inferiore në këtë proces. Tani Serbia është fuqizuar dhe kam një frikë se kjo situatë mund ta sjellë Kosovën që të pranojë çdo gjë që i ofrohet në këtë proces, e jo ajo që është në interes të qytetarëve të Kosovës.

“Epoka e re”: BE-ja po insiston në dialog teknik, ndërsa qeveria ka thënë se me Serbinë do të ketë vetëm dialog politik.

Shala: Me Serbinë nuk ka pasur, nuk ka dhe asnjëherë nuk do të ketë dialog teknik. Me Serbinë, edhe nëse flasim për dardha dhe molla, ajo është çështje politike. Kjo ka qenë një shpikje krejtësisht e panevojshme, sepse nuk mund të ketë sukses në dialogun teknik nëse nuk është arritur marrëveshje politike. Këto janë përralla. Pavarësisht se kush shkon në Bruksel, Skender Hyseni apo dikush tjetër, me Serbinë kemi vetëm bisedime politike.

Selimi thotë se janë të përkushtuar për realizimin e procesit të reformës në drejtësi



Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka thënë se si tregues dhe dëshmi të përkushtimit të qeverisë për realizimin e procesit të reformës në drejtësi dhe për të bërë hapa përpara për fuqizimin e sundimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës, kabineti qeveritar në mbledhjen e së mërkurës ka votuar vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e modaliteteve dhe skenarëve për çështje të reformës në sistemin e drejtësisë me qëllim të adresimit të llogaridhënies, përfshirë edhe vetingun

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 22 KORRIK - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka mbajtur të mërkurën një konferencë për media, nëpërmjet së cilës e ka njoftuar opinionin publik lidhur me vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e modaliteteve dhe skenarëve për çështje të reformës në sistemin e drejtësisë me qëllim të adresimit të llogaridhënies duke përfshirë edhe vetingun, i cili është votuar të mërkurën në mbledhjen e qeverisë. "Si tregues dhe dëshmi të përkushtimit të qeverisë për realizimin e procesit të reformës në drejtësi dhe për të bërë hapa përpara për

fuqizimin e sundimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës, kabineti qeveritar në mbledhjen e sotme ka votuar vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e modaliteteve dhe skenarëve për çështje të reformës në sistemin e drejtësisë me qëllim të adresimit të llogaridhënies, duke përfshirë edhe vetingun", ka thënë Selimi.

Ai ka bërë me dije se pjesë e grupit punues, i cili është gjithëpërfshirës me qëllim të garantimit të objektivitetit dhe transparencës, do të jenë përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile, të gjithë hisedarët e sistemit të drejtësisë dhe në rolin mbështetës do të jenë përfaqësues nga Zyra e

Bashkimit Evropian në Kosovë, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, Ambasada e Gjermanisë, Ambasada e Italisë, përfaqësues nga Misioni i OSBE-së. "Për ta respektuar parimin e inkluzivitetit dhe punën e deritanishme, në vendim është përfshirë edhe grupi sipas vendimit 08/04 të datës 28.02.2020, të cilët i ftoj të jenë pjesë e procesit të dizajnit të sistemit të llogaridhënies, duke përfshirë edhe vetingun. Puna e grupit punues është e përkufizuar në kohë, deri në fund të muajit tetor të këtij viti. Ky grup do ta përgatisë raportin përfundimtar mbi skenarët e reformës në sistemin e

drejtësisë, duke i marrë për bazë edhe rekomandimet e procesit të rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit. Raporti i grupit punues do të shfrytëzohet si bazë mbi të cilin Qeveria dhe Ministria e

Drejtësisë, në bashkëpunim me aktorët e tjerë si dhe partnerët strategjikë, do të procedojnë më tutje reformën. Mbledhja e parë e këtij grupi pritet të mbahet në javën tjetër përmes një videokonference", ka deklaruar Selimi.

GLPS-ja: Procesi i vetingut në sistemin e drejtësisë është i domosdoshëm

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka bërë me dije se ka kërkuar ndër vite fillimin e një procesi vetingu në sistemin e drejtësisë me qëllim që të largohen elementet e kapjes mbi të, duke garantuar kështu që figura e gjyqtarëve dhe e prokurorëve u nënshtrohet parimeve të profesionalizmit, integritetit, pastërtisë së pasurisë e të kaluarës. "Së fundmi, Ministria e Drejtësisë dhe qeveria kanë vendosur ta ndalin procesin dizajnit të vetingut, duke shpikur kështu një proces kinse të reformës në sistemin e drejtësisë në vend të vetingut të gjyqtarëve e prokurorëve. GLPS vlerëson që një tendencë e tillë e qeverisë është e gabuar dhe do të sjellë më shumë mjegull sesa qartësi në lidhje me nevojën për një vetingu ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë. Siç është theksuar në dhjetëra raporte ndërkombëtare e vendore, sistemi i drejtësisë në Kosovë ka probleme serioze me mekanizmat e përgjegjësisë, në shumë raste, probleme serioze me figurën dhe pastërtinë e gjyqtarëve e

prokurorëve të caktuar dhe drejtuesve të sistemit dhe në kuptimin statistikor, ka probleme serioze me performancën në raport me dënimin e figurave të larta të krimit të organizuar e korrupsionit politik. Fakti që ende nuk ka një numër dënimesh serioze ndaj figurave të larta të krimit të organizuar e korrupsionit është tregues i mjaftueshëm për defektet dhe cilësitë e munguara që janë të pranishme në sistemin e drejtësisë. GLPS në vazhdimësi ka argumentuar që rrënjët e dukurive të tilla nuk janë të lidhura me organizimin, strukturat, apo faktorët infrastrukturorë ligjorë. Ato janë, para së gjithash, të lidhura me figurën, guximin dhe profesionalizmin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve që ndjekin e gjykojnë këto raste gjyqësore", thuhet në komunikatën e GLPS-së. Më tutje, në këtë komunikatë theksohet se një proces vetingu në sistemin e drejtësisë është i domosdoshëm për t'i hapur rrugë një reforme serioze në fushën e sundimit të ligjit.

Sistemi aktual i arsimit dhe aftësimit profesional nuk u përgjigjet nevojave dhe kërkesave të tregut të punës

EPOKA E RE**Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 22 KORRIK - Zyra Kombëtare e Auditimit ka publikuar raportin e auditimit "Efektiviteti i ndërlidhjes së arsimit dhe aftësimit profesional me nevojat e tregut të punës". Auditimi është kryer në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe komunat: Prishtinë, Prizren dhe Ferizaj si dhe ka pasur për qëllim ta vlerësojë efektivitetin e masave të ndërmarra nga institucionet publike për zhvillimin e njohurive dhe aftësive profesionale dhe ndërlidhjen e tyre me nevojat e

vazhdueshme të tregut të punës.

Pavarësisht prej përpjekjeve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të aktorëve relevantë për t'i rishikuar kurrikulat e profileve të arsimit dhe aftësimit profesional dhe për t'i bazuar ato në zhvillimin e standardeve të profesionit, ky qëllim nuk është arritur për faktin se një pjesë e konsiderueshme e kurrikulave nuk janë rishikuar ende dhe një numër shumë i kufizuar i institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional janë duke zbatuar kurrikulat e rishikuara. Po ashtu, mësimi praktik në punëtoritë e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional dhe praktika



profesionale në biznese janë realizuar me vështirësi dhe ngecje të mëdha. Institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të ofrojnë

mundësi efektive për përvetësimin dhe zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive dhe nuk kanë siguruar se janë krijuar kushtet e nevojshme

për zbatimin e formave duale të arsimit, kushte këto që mundësojnë realizimin e mësimi praktik në ambientet e shkollës dhe praktikës profesionale në biznese.

Kjo është pamundësuar për shkak të mungesës së pajisjeve të nevojshme në shkolla, mungesës së kabineteve apo punëtorive, problemeve me pajisjet aktuale, mungesës së materialit shpenzues etj.

Me qëllim të adresimit të shpejtë të çështjeve për të ndërlidhur arsimin dhe aftësimin profesional me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 16 rekomandime për institucionet përkatëse.

NJË GRUP I VOGËL I QYTETARËVE KANË PROTESTUAR KUNDËR NDËRTIMIT TË XHAMISË SË MADHE NË PRISHTINË

Shumica e qytetarëve janë për ndërtimin e Xhamisë së Madhe në Prishtinë

Një grup i vogël i qytetarëve të mërkurën kanë protestuar në lagjen "Dardania" kundër ndërtimit të Xhamisë së Madhe në Prishtinë. Në këtë protestë ka pasur mospajtime mes dy grupeve të protestuesve, një pjesë e protestuesve kanë kundërshtuar ndërtimin e kësaj xhamie, kurse një pjesë tjetër e qytetarëve kanë thënë se xhamia duhet të ndërtohet. Përkrahje ndërtimit të kësaj xhamie të mërkurën i kanë dhënë presidenti Hashim Thaçi dhe kryetari i LDK-së, Isa Mustafa. Sipas një sondazhi të fundit, 84 për qind e qytetarëve përkrahin ndërtimin e Xhamisë së Madhe në Prishtinë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 KORRIK - Të mërkurën një grup i vogël qytetarësh ka protestuar në lagjen "Dardania" kundër ndërtimit të Xhamisë së Madhe në Prishtinë, e cila ishte organizuar nga ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Binak Gashi. Në këtë protestë ka pasur mospajtime mes dy grupeve të protestuesve, një pjesë e protestuesve kanë kundërshtuar ndërtimin e kësaj xhamie, kurse një pjesë tjetër e qytetarëve kanë thënë se xhamia duhet të ndërtohet.

Gjatë kohës sa është mbajtur protesta, një numër i konsiderueshëm i policëve kanë qëndruar afër vendit ku është duke u ndërtuar kjo xhami. "Qëllimi i protestës të cilën unë e kam paralajmëruar nuk ishte ndalimi i ndërtimit të xhamisë, as nuk do të ndodhte ndonjëherë që unë të jem kundër ndërtimit të xhamive. Qëllimi i vetëm i protestës ishte transparenca. Do të thotë, të dimë se kush po i vë themelet e saj. Qëllimi i atyre që po vënë themelet e xhamisë më ka frikësuar se do t'i bëjë dëm vendit tonë. Unë nuk kam qenë,

nuk jam e as në të ardhmen s'do të jem kurrë kundër fesë islame, aq më pak që t'i lë besimtarët t'i kryejnë lutjet e tyre në rrugë, shi dhe borë. Kam dhënë kontributin tim në luftë vetëm që ta gëzojmë të gjithë lirinë, pa bërë dallime fetare, racore e gjinore", ka thënë ish-komandanti i UÇK-së, Binak Gashi.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar pas protestës që është mbajtur kundër ndërtimit të Xhamisë së Madhe në Prishtinë. KMDLNj ka theksuar se të drejtat dhe liritë fetare në Kosovë, si pjesë shumë e rëndësishme e korpusit të të drejtave themelore të njeriut,

janë të rregulluara me ligjet e Kosovës për të gjitha komunitetet fetare dhe besimtarët e të gjitha besimeve e që janë në përputhje të plotë me dokumentet dhe konventat ndërkombëtare që i rregullojnë të drejtat e besimit dhe zbatimit të fesë. "KMDLNj fton të gjithë qytetarët e Prishtinës, për rastin konkret, por edhe të Kosovës, ta ruajnë dhe kultivojnë tolerancën fetare dhe të mos e tensionojnë situatën duke respektuar të gjitha besimet dhe besimtarët pa bërë asnjë dallim. KMDLNj mbron të drejtat dhe liritë fetare pa bërë asnjë dallim dhe e dënon çdo shkelje të këtyre të drejtave", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.



Ndaj kësaj proteste ka reaguar edhe presidenti i vendit, Hashim Thaçi dhe kryetari i LDK-së, Isa Mustafa. Presidenti Thaçi ka thënë se ndihet mirë dhe krenar që së bashku me kreun e komunitetit të besimtarëve të krishterë dhe me ish-presidentin Ibrahim Rugova kanë vënë gurthemelin e Katedrales në Prishtinë. Po ashtu, ai ka theksuar se ndihet mirë dhe krenar që së bashku me kreun e komunitetit të besimtarëve myslimanë dhe me ish-presidentin Jahjaga e kanë vënë edhe gurthemelin e xhamisë në Prishtinë. "Kosova është shembulli më i mirë, jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë për tolerancën dhe bashkëjetesën e shkëlqyer ndër fetare, shekuj me radhë. Askush nuk ka asnjë arsye që të ndihet i fyer, i anashkaluar apo i privilegjuar mbi baza fetare në shtetin tonë modern. Protesta dhe shprehja e pakënaqësisë janë vlera demokratike në shoqërinë tonë, por ato asnjëherë nuk duhet të shërbejnë për nxitjen e urrejtjes ndër fetare dhe ndëretnike", ka thënë Thaçi.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë se protestat janë pjesë e

ekspozimit demokratik, sikurse kjo e sotmja kundër ndërtimit të Xhamisë së Madhe në Prishtinë. Mustafa ka thënë se kjo protestë tregon edhe kompleksin e inferioritetit tonë që të pajtohemi se jemi këta që jemi, rreth 95 për qind myslimanë. "Tendenca që ta diktosh besimin dhe objektet fetare nuk përkon me respektimin tonë të ndërsjellë dhe as me respektimin e vetvetes. Pse duhet të na pengojë një xhami e madhe, një katedrale, një kishë në Prishtinë. Qytetet më të mëdha ua kanë vënë qytetarëve të tyre vendet më të mira për xhami, siç është Londra. Është Tirana. Këtë e kam bërë edhe unë sa isha kryetar i Prishtinës. E inkurajoj kryetarin Ahmeti ta vazhdojë ofrimin e zgjidhjes më të mirë për ndërtimin e kësaj xhamie. Të mundohesh që të paraqitesh ai që nuk je, s'është asgjë më pak sesa primitivizëm", ka deklaruar Mustafa.

Ndërkaq në një sondazh të realizuar nga RTV Dukagjini mbrëmë, në të cilin kanë votuar 35 268 persona, pro ndërtimit të Xhamisë së Madhe kanë votuar 29 750 persona, ose 84 për qind, ndërkaq kundër kanë qenë 5 518 persona ose 16 për qind.

FSSHK-ja: Turpi i radhës nga ana e politikbërësve ndaj punëtorëve shëndetësorë

PRISHTINË, 22 KORRIK (ER) - Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e vet të fundit, ka hequr nga rendi i ditës pikën për aprovimin e shtesave mujore prej 300 eurosh për personelin shëndetësor për angazhim shtesë për muajin korrik dhe gusht të vitit 2020, të cilët janë të ekspozuar ndaj virusit Covid-19. Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) përmes një reagimi për media ka theksuar se ky është një vendim skandaloz. "Kësaj radhe qeveria Hoti, në vend se të na ndihmojë në këtë luftë e cila e kapluar popullatën tonë,

merr vendime skandalozë dhe provokuese.

FSSHK-ja në koordinim të plotë me të gjitha odat e profesionistëve shëndetësorë reagon ashpër dhe kërkon: 1) Që shtesa mujore prej 300.00 eurosh për personelin shëndetësor të paguhet për muajt maj dhe qershor e jo për muajt korrik e gusht; 2. Që të miratohet me rishikim të buxhetit shtesa mbi pagë konform vlerave të koficientëve që kanë qenë të përfshira në katalogun e Ligjit të shfuqizuar për pagat në sektorin publik deri në aprovimin e ligjit të ri për pagat në sektorin publik

(me disa ndryshime). E njoftojmë opinionin e gjerë se FSSHK-ja së bashku me odat e profesionistëve shëndetësorë ka tri ditë që ka kërkuar takim me kryetaren e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, në lidhje me kërkesat të cilat do të duhet të miratohen nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, por ky takim deri më tani nuk është zhvilluar. Duke qenë të vetëdijshëm se jemi në kohë pandemie, ku të gjithë punëtorët shëndetësorë janë të stërvitur (po jua rikujtojmë se janë të vetmit që nuk kanë pushuar që nga muaji mars), e tashmë edhe të



ofenduar nga qeveritarët, vendimet e sotme janë më se demotivuese", është thënë në këtë reagim.

FSSHK-ja ka paralajmëruar veprime sindikale, për të cilat janë pajtuar edhe profesionistët shëndetësorë.

Xhemajli: Qeveria ta parandalojë shitjen e IPKO-s te Telekom Serbia

PRISHTINË, 22 KORRIK (ER) - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Bajrush Xhemajli, ka thënë të mërkurën, në konferencë për media, se përpjekja e Telekom Serbisë për blerjen e operatorit IPKO si pjesë e Telekom Sllovenia përbën rrezik të madh dhe cenon rëndë sigurinë kombëtare të shtetit të Kosovës. Xhemajli ka thënë se është shqetësuese se gjithë këtë ngjarje deri më tani e ka përcjellë heshtja e vazhdueshme e institucioneve të shtetit të Kosovës, duke përfshirë qeverinë e kaluar të Albin Kurtit dhe qeverinë aktuale të Avdullah Hotit. Deputeti Xhemajli ka kërkuar që kryeministri të ftojë urgjentisht mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare për ta analizuar dhe

parandaluar qasjen e Serbisë në telekomunikimin e Kosovës nëpërmjet blerjes së operatorit IPKO. "Shteti i Kosovës është duke u ballafaquar me një rrezik të madh që cenon rëndë sigurinë tonë kombëtare. Informatat se operatori IPKO, si pjesë e Telekom Sllovenia, mund t'i shitet Telekomit të Serbisë, janë tejet shqetësuese, të papranueshme dhe sulme ndaj sigurisë kombëtare të shtetit të Kosovës. Është shqetësuese se gjithë këtë ngjarje deri më tani e ka përcjellë heshtja e vazhdueshme e institucioneve të shtetit të Kosovës. Qeveria Kurti dhe tani qeveria Hoti nuk kanë bërë as edhe një lëvizje të vetme për të ndaluar këtë skenar të rrezikshëm për Republikën e Kosovës", ka thënë Xhemajli.



Kuçi dhe udhëheqësit e Odës Tregtare Kosovare-Turke diskutuan për bashkëpunimin ekonomik



PRISHTINË, 22 KORRIK (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka pritur të mërkurën në takim udhëheqësit e Odës Tregtare Kosovare-Turke, Abdurrahman Balkiz dhe Esin Muzbeg. Ministri Kuçi u ka dëshiruar mirëseardhje dhe i ka njoftuar në terma të gjerë për situatën ekonomike në vend dhe për planet e Qeverisë së Kosovës për të dalë nga kjo gjendje e ndikuar nga Covid-19. Kryetari i OTKT-së, Abdurrahman Balkiz, e ka uruar ministrin Kuçi për pozitën e tij në

këtë qeveri dhe e ka njoftuar për bizneset turke që veprojnë në Kosovë. Ai ka potencuar se Marrëveshja e Tregtisë së Lirë në mes të Turqisë dhe Kosovës ka dhënë efektet e saj, por ka ngritur për diskutim edhe disa çështje që duhen përmirësuar, që të arrihet një sukses më i madh. Më tej, është theksuar se në lidhje me këtë kërkesë ministri Blerim Kuçi ka thënë se janë ta gatshëm kurdo që ta zgjidhin praktikisht secilin problem apo barrierë që të sigurojnë një zhvillim të tregtisë sa më të mirë mes dy vendeve.

Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së u jep përkrahje prioriteteve të ministrit Reçica

Drejtuesit e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së i kanë dhënë përkrahje të plotë ministrit Reçica për angazhimet e MPMS-së në funksion të jetësimit të prioriteteve, me theks të veçantë për ta krijuar bazën ligjore që ua mundëson për të punuar në sektorin privat

PRISHTINË, 22 KORRIK (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, Fadil Shurdhaj, bashkë me sekretarin e shoqatës, Enver Krasniqi, me të cilët ka bashkëbiseduar lidhur me gjendjen, angazhimin dhe nevojat e shoqatës në këtë periudhë të vështirë pandemie. Në këtë takim, drejtuesit e

Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së i kanë dhënë përkrahje të plotë ministrit Reçica për angazhimet e MPMS-së në funksion të jetësimit të prioriteteve, me theks të veçantë për ta krijuar bazën ligjore që ua mundëson për të punuar në sektorin privat të gjithë veteranëve të luftës së UÇK-së si dhe për lejimin e përfitimit në më shumë pensione për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës.



Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike Covid-19

Mundësohet tërheqja e 10-përqindëshit nga Fondi Pensional



Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike Covid-19, i cili do të mundësojë ndryshimin e disa ligjeve. Ky projektligj do t'u mundësojë qytetarëve kontributpagues të tërheqin 10 për qind të mjeteve nga llogaria e tyre në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 22 KORRIK - Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti, ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e 15-të të rregullt, në të cilën ka miratuar projektligje dhe vendime nga fushat e përgjegjësi kushetuese dhe ligjore. Me vendimin e parë që është miratuar në këtë mbledhje të qeverisë është aprovuar Projektligji për Rimëkëmbje Ekonomike Covid-19, qëllimi i të cilit është plotësimi dhe ndryshimi i disa ligjeve, me qëllim të rimëkëmbjes së ekonomisë së Republikës së Kosovës pas efekteve negative të shkaktuara nga pandemia Covid-19. Me këtë rast do të plotësohen dhe ndryshohen ligjet si në vijim: Ligji për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore; Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës; Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale; Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar; Ligji për Menaxhimin e

Financave Publike dhe Përgjegjësitë; Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave; Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat; dhe Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ky ligj do të mbetet në fuqi deri më 31.12.2021. Pas kësaj date të gjitha dispozitat e këtij ligji do të shfuqizohen në mënyrë automatike. Ky projektligj do t'u mundësojë qytetarëve kontributpagues të tërheqin 10 për qind të mjeteve nga llogaria e tyre në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me financimin e Projektit Emergjent Covid-19 për Kosovën. Marrëveshja i siguron Republikës së Kosovës një kredi në shumën prej 46 milionë eurove, me normë të ulët interesi dhe me një periudhë të shlyerjes 20-vjeçare dhe një periudhë greis prej 5

vjetësh. Kredia do të përdoret për rritjen e kapaciteteve shëndetësore në menaxhimin e pandemisë Covid-19 si dhe për sanimin e pasojave të pandemisë. Ministria e Financave, Hykmete Bajrami, ka thënë se me ndryshimet që do t'i bëhen Ligjit për Fondin Pensional, Fondi autorizohet që brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji t'u mundësojë qytetarëve të Kosovës që të tërheqin 10 për qind të kursimeve pensionale. Ajo ka bërë me dije se tërheqja e fondeve nuk do të kompensohet nga qeveria, por ata që tërheqin mjetet do të jenë të liruar nga obligimet tatimore. "Projektligji ka një qasje horizontale të ndryshimit të ligjeve që zakonisht rregullohen çështje të ndryshme që nuk janë të lidhura në aspektin sektorial dhe këto zakonisht miratohen që efekti i zbatimit të tyre të jetë më i shpejtë. Me anë të këtij projektligji ndryshohen dhe plotësohen: Ligji për Fondin për Garanci Kreditore, Ligji për Fondin Pensional, Ligji për Tatimin e të Ardhurave të Korporatave, Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatimit, Ligji për të Ardhurat Personale si dhe Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", ka bërë me dije Bajrami. Projektligji është thënë se do të dërgohet menjëherë në Kuvendin e Kosovës për miratim. Vlera e përgjithshme që do të

mund të tërhiqej nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, sipas projeksioneve të Ministrisë së Financave, është rreth 180 milionë euro, mjete këto të cilat do ta stimulonin kërkesën agregate në treg. Stimulimi i kërkesës agregate nënkupton rritjen e shpenzimeve që eventualisht do të bënin qytetarët pas marrjes së parave nga kontributet pensionale. Të gjithë të punësuarit (e regjistruar) në Kosovë paguajnë 10 për qind kontribute pensionale nga paga e tyre, përkatësisht 5 për qind paguan punëdhënësi, kurse 5 për qind paguhen nga paga e të punësuarit. Deri më tani, dy miliardë euro ka arritur vlera e mjeteve të rreth 700 mijë kontributpaguesve në Kosovë që i menaxhojnë Fondin e Kursimeve Pensionale. Kabineti qeveritar në këtë mbledhje ka miratuar vendimin për themelimin e Ekipit Nacional për hartimin e Strategjisë për Specializim të Mençur. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i mëparshëm i datës 07.08.2018 dhe qëllimi i plotësim-ndryshimit të këtij vendimi është që ta reflektojë strukturën e re organizative të qeverisë si dhe duke u mbështetur në përvojat e vendeve të tjera që kanë kaluar në këtë proces. Vendimi siguron një gjithëpërfshirje më të madhe të sektorit qeveritar, biznesit, akademisë dhe shoqërisë civile. Gjithashtu, është miratuar edhe

Plani i Veprimit 2020-2021 për zbatimin e Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave "Sistemi i Planifikimit të Integruar" 2017-2021, i cili ka për qëllim zbatimin e Strategjisë për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë që përbën njëri nga tri strategjitë kryesore që ndërlihen me Kornizën Strategjike të Kosovës për Reformën e Administratës Publike, së bashku me Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2014-2020, Strategjinë për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2018 dhe Strategjinë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike. Qeveria e Kosovës të mërkurën ka themeluar Komisionin ad-hoc për përzgjedhjen e katër anëtarëve të Bordit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale. Miratimin e Qeverisë e ka marrë edhe vendimi për t'i kërkuar presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit për ministren e Financave për nënshkrimin e Amendamentit Nr. 1 të Marrëveshjes mes Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë, lidhur me Programin Kornizë për Bashkëpunim Financiar. Qëllimi i marrëveshjes është ofrimi i një kredie të butë në vlerë prej 62 milionë eurosh. Sipas marrëveshjes, sektorët që mbështeten nga ky financim janë ai i ujit dhe ujërave të zeza dhe sektori i infrastrukturës.

Përrurohet platforma elektronike për shërbime administrative 'E-kiosk' në Junik

JUNIK, 22 KORRIK (ER) - Komuna e Junikut nga sot përmes shërbimit elektronik 'E-kiosk' u mundëson qytetarëve marrjen e shërbimeve

administrative në çdo kohë. Qytetarët përmes platformës elektronike 'E-kiosk' mund t'i shkarkojnë dokumentet si: Certifikata e lindjes,

ekstraktin nga regjistri qendror, certifikatën e martesës, certifikatën e shtetësisë dhe certifikatën e vendbanimit. 'E-kiosku' do të jetë në shër-

bim të qytetarëve 24/7. Projekti është realizuar në kuadër të iniciativës "Shërbime të mira dhe lehtë të qasme për qytetarë".



Institucionet në Malishevë u bëjnë thirrje qytetarëve për respektimin e masave kundër Covid-19

MALISHEVË, 22 KORRIK (ER) - Komuna e Malishevës, Policia e Kosovës dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Malishevë të mërkurën, pas një takimi të përbashkët të udhëheqësve të tri institucioneve, u kanë bërë thirrje qytetarëve që t'i zbatojnë vendimet dhe udhëzimet e IKShPK-së dhe të Ministrisë së Shëndetësisë për t'u mbrojtur nga Covid-19.

Krerët e të tri institucioneve në Malishevë e kanë bërë këtë thirrje, pasi në ditët e fundit ka pasur disa raste të vdekjeve, ndërsa pjesëmarrja në ceremonitë e varrimit ka qenë në kundërshtim me vendimet e institucioneve përgjegjëse shëndetësore dhe, si pasojë, mund të kemi përhapje të virusit dhe dalje të situatës jashtë kontrollit. Për këtë qëllim kanë mbajtur një takim të përbashkët, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, komandanti i Stacionit Policor në Malishevë, kapiten Azem Krasniqi, kryetari i Bashkësisë Islame në Malishevë, Sead Paçarizi dhe drejtori i Inspektoratit, Dibran Kastrati,

të cilët kanë kërkuar nga qytetarët që t'i zbatojnë vendimet dhe udhëzimet e institucioneve shëndetësore. "Jemi duke u përballur me një gjendje emergjente shëndetësore si pasojë e pandemisë së Covid-19, prandaj kërkojmë nga të gjithë t'i zbatojnë vendimet dhe udhëzimet e institucioneve përgjegjëse shëndetësore, e në këto vendime ndalohej edhe grumbullimi i qytetarëve, përfshirë edhe ceremonitë e varrimit.

Qytetarët të nderuar, grumbullimet e tilla kontrollohen me vështirësi, prandaj të mos bëhemi shkaktarë të përhapjes së virusit, ta mbrojmë veten, t'i mbrojmë të afërmit tanë dhe ta mbrojmë shëndetin e qytetarëve. Mbrojtja është arma e vetme e luftimit të kësaj pandemie, prandaj të reduktohet pjesëmarrja në ceremonitë e varrimeve dhe ato të zhvillohen vetëm me rrethin e ngushtë familjar", thuhet në apelin e krerëve të tri institucioneve drejtuar qytetarëve.

Komuna e Malishevës dhe të gjitha institucionet e tjera i shprehin ngushëllime familjes



së biznesmenit nga Bubaveci i Malishevës, Latif Kryeziu, vdekja e të cilit është një humbje e madhe jo vetëm për familjen, por edhe për Malishevën. Në të njëjtën kohë kërkohet mirëkuptim nga të gjithë miqtë

dhe komuniteti i biznesit, që me rastin e varrimit të tij, që pritet të bëhet sot në Bubavec, të mos grumbullohen për ceremoninë e varrimit dhe pjesëmarrja në varrim të jetë sa më e vogël, pasi kjo mund ta rreziko-

jë seriozisht shëndetin e qytetarëve, sepse virusi Covid-19 është i pranishëm dhe mund të sjellë probleme serioze në përhapjen e tij dhe rrjedhimisht situata të dalë jashtë kontrollit.

Gjilani humbi 788 vende të punës gjatë pandemisë



GJILAN, 22 KORRIK (ER) - Komuna e Gjilanit ka përgatitur raportin e dëmeve të shkaktuara në sektorin e ekonomisë gjatë periudhës së përbashkës me pandeminë globale Covid-19. Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik në Gjiilan, Valbona Tahiri, gjatë konferencës për media ka thënë se masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës në mars të këtij viti, për kufizimin lëvizjes së qytetarëve, ndërprerjen e procesit mësimor në shkolla dhe universitete, ndërprerjen e pjesës

dërrmuese të aktiviteteve të bizneseve, përfshirë mbylljen e plotë të disa prej tyre, kanë bërë që të ketë një stagnim në zhvillimin ekonomik edhe në këtë komunë. Ajo ka treguar se gjatë kësaj kohe janë humbur 788 vende pune. "Pandemia ka ndikuar në humbjen e 788 vendeve të punës. Kemi një rënie prej 23 përqindësh të numrit të gjithëmbarshtëm të punëtorëve të kompanitë e anketuara, kryesisht bizneset e mëdha dhe të mesme. E njëjta situatë është deklaruar edhe

nga bizneset e vogla. 46 për qind e bizneseve kanë deklaruar rënie të nivelit të shitjes prej 90-100 përqindësh dhe vetëm 1 për qind e bizneseve të anketuara kanë deklaruar se niveli i shitjes ka qenë i njëjtë", ka theksuar ajo. Ndërsa kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se shëndeti i ekonomisë në këtë komunë është prioritet i lartë. Në këtë konferencë janë paraqitur edhe disa rekomandime se si të tejkalohet kjo situatë.

Nis regjistrimi i fëmijëve në çerdhen "11 Marsi" në Prizren

PRIZREN, 22 KORRIK (ER) - Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se nga e mërkura ka filluar regjistrimi i fëmijëve në çerdhen e parë publike në lagjen "11 Marsi" pranë Shkollës Filllore "Lekë Dukagjini" në këtë komunë. Sipas kësaj komune, në këtë çerdhe do të regjistrohen 160 fëmijë të moshës nga 3 deri në 6 vjet.

"Numri i fëmijëve, të cilët mund të regjistrohen në kopsht, është gjithsej 160 (120 fëmijë në gjuhën shqipe, 20 në gjuhën boshnjake dhe 20 në gjuhën turke). Kopshti ka staf profesional, i përgatitur për ofrimin e të gjitha shërbimeve edukative, njohëse, emocionale dhe shëndetësore (edukatorët e kualifikuar,

pedagogun, psikologun dhe mjekun). Raporti edukator-fëmijë është 2:22. Qëndrimi i fëmijëve në kopsht është tërëditor. Regjistrimi i fëmijëve bëhet çdo ditë pune nga ora 10:00-15:00 në objektin e çerdhes në lagjen '11 Marsi'. Afati i fundit për regjistrim është data 20 gusht 2020", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



EDHE NJË HERË NJË KUJTESË MBI VLERAT E UÇK-së DHE TË LUFTËS QË MBARTI AJO (14)



Shkruan: Kudusi LAMA

Akuzat që bën raporti i Dick Martyt, pa farë dhembjeje dhe pa farë ndjenje humanizmi, duke tentuar ta bëjë viktimën kriminel dhe kriminelin viktimë, me një rrëmbim të përsheptuar, nuk mund të ketë emër tjetër veçse ultrashovinizëm. Në atë raport dallohet qartë se tentativa për ta kriminalizuar UÇK-në dhe luftën e saj është montuar në Beograd, por pse nuk arrijnë ta kuptojnë këtë parlamentarët evropian, këtu nuk arrij ta kuptoj. A nuk arrijnë të lexojnë deklarime të tilla si: "Zëvendësi i prokurorit të Serbisë, Bruno Vekariç, thotë se përfaqësuesit e prokurorisë serbe shumë herë janë takuar me Dick Martyn, me të cilin kanë shkëmbyer informacione. Nëse shikoni raportin, do të shihni se pjesa që ka lidhje me strukturën e organizimit të UÇK-së është pjesë e marrë nga raporti ynë që e kemi dërguar ne. Po ashtu, në raport ndodhen edhe pjesët që i kemi dhënë ne për dëshmitë lidhur me trafikimin e organeve njerëzore, si dhe për lidhjen e krimit të organizuar me qarqet politike", pohon Vekariç. Vetëm këtë deklarim po të marrësh në konsideratë kupton se cila është vlera e këtij raporti që tenton të vendosë në vend "drejtësinë", që ngriti këtë Gjykatë Speciale e cila po na merr nën akuzë djemtë që na sollën lirinë, e që po gëzon serbët dhe disa shqiptarë gjakprishur. Por unë nuk pretendoj që t'i jap drejtësi Dick Martyt, pasi ai duket se kënaqësinë e vet e mbështet në gjetjen e të këqijave të tjerët, edhe atje ku nuk ka, por pse në këtë kurth ka rënë një parlament e tërë i demokracisë evropiane, më duket vërtet absurditet, kur dihet prej të gjithëve se nënat, gratë, motrat dhe bijat shqiptare edhe sot vazhdojnë të vajtojnë në pritje të të dashurve të tyre, të grabitur e të zhdukur nga Serbia. Ndërsa zotëri Marty kërkon të gjejë ata që nuk kanë as emër, as adresë, as familje, as identitet, për të cilin nuk vajton askush, sepse nuk ekzistojnë, duke hedhur mënjanë mijëra shqiptarët e zhdukur sikur të ishin milingona, të cilat edhe ata duhen trajtuar me respekt se janë qenie të gjalla që shërbejnë për një mision të caktuar. Prandaj edhe bashkohem me mendimin se: "...askush tjetër

nuk i bën më shumë të vuajne sot viktimat shqiptare sesa këto shpifje monstruoze të inskenuara nga Dick Marti e përkrahësit e tij...". Pasi di prej gjithë historisë dhe traditës sonë kulturore, se ai që të fyen të shkakton vuajtje më shumë se ai që të vret, pasi ai që të vret të shkakton dhembje një ditë, kurse ai që të fyen të shkakton dhembje çdo ditë. Nuk di nëse e kupton këtë zotëri Marty, që është vënë në një pozicion me serbët për t'i fyer dhe shpërdoruar shqiptarët? Por unë prapë tërhiqem, se gaboj kur mendoj për Dick Martyn si për një qytetar, pasi ai e ka treguar me veprën e tij se nuk ka farë lidhjeje me qytetarin evropian, se po të kishte nuk do të shitej në atë nivel sa të ishte i detyruar ta hidhte baltën e kriminelit mbi viktimën. Por, megjithatë, unë u bëj thirrje të gjithë shqiptarëve, që të mos e humbasin shpresën në drejtësinë ndërkombëtare, se nuk është Dick Marty - Evropa, se edhe Evropa ka mbeturinat e saj që i hedh jashtë rast pas rasti, një ditë do ta kuptojë të vërtetën dhe do ta hedhë në koshin e plehrave Dick Martyn me gjithë raportin e tij, pasi shqiptarët do të vënë përballë Evropës ndershmërinë dhe transparencën, për të parë gjithçka siç ishte dhe është në të vërtetë. Ndërsa atyre që gëzojnë kur shikojnë se po merren nën hetim nga Gjykata Speciale e luftëtarëve të lirisë, ju them mos pështyni mbi bukën që po hani se do ta helmoni veten. Djemtë dhe vashat e UÇK-së as i kanë bërë dëm kujt, as kanë kryer krime. Ata janë flamurtarët e lirisë. 22 qershor 1999 është dita e parë e lirisë së Kosovës. Ajo është dita e fundit kur duhet të kishte përfunduar lufta. Nuk di pse për politikë të ditës ka të tillë që e hedhin gëlbasën e tyre përtej 22 qershorit të vitit 1999. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka ardhur si një kërkesë e domosdoshmërisë së qenies shqiptare të rrezikuar në disa nga trevat e pushtuara nga sallahoseria në tridhjetë vjetët e fundit të shekullit 19 dhe në njëzetë vjetët e para të shekullit 20. Ushtria Çlirimtare e Kosovës mori mbi vete përgjegjësitë më të mëdha kombëtare në dekadën e fundit të shekullit 20, për të vendosur drejtësi në këtë pjesë të tokave shqiptare. Me veprën e saj luftarake kundër Serbisë (realisht Jugosllavisë së mbetur - Serbi e Mali i Zi), Ushtria Çlirimtare e Kosovës u bë figura më e madhe kombëtare me përmasat e së cilës u evidentua kombi shqiptar në tërësi dhe synimet e tij për të ardhmen. Dihet se në Kosovë është luftuar

vazhdimisht. Luftëtarët shqiptarë nëpër kohë e kanë tronditur pandërprerë pushtuesin, në gjithë rrjedhën historike të përlëshjeve. Por më të freskëta janë luftërat shqiptare kundër pushtimeve serbe e jugosllave, të cilat kanë dhënë dëshmi të vazhdueshme për synimet shqiptare për lirinë kombëtare. Duke marrë në evidencë ecurinë e jetës kombëtare në trevat e pushtuara, shihet qartë se asnjëherë këtu nuk ka pushuar lufta. Ky është treguesi se Ushtria Çlirimtare nuk ishte as një rastësi e as një aksident. Ajo ishte rrjedhë e normalitetit të zhvillimit kombëtar të mbetur nën pushtim, pa të cilin nuk mund të kishte ardhmëri për shqiptarët. Çdo mendim dhe deklaram ndryshe është abuzim e keqdashje dhe, megjithëse shumëkush nuk ka dëshirë ta dëgjojë sot fjalën armik, unë them se ndaj çdo mendimi a deklarimi kundër UÇK-së duhet të jemi shumë vigjilentë dhe t'i vëmë emrin që i takon - kundërshqiptarizëm dhe armiqësi e hapur kundërshqiptare, që gjithnjë burimin e ka në Beograd dhe Athinë, pavarësisht se prej ku legalizohet, qoftë edhe si në rastin e raportit të Dick Martyt, që mori autorësinë dhe autoritetin e Parlamentit të Evropës dhe u implementua me këtë Gjykatën Speciale ndërkombëtare për t'i maltretuar luftëtarët e UÇK-së. Pushtimi gjithnjë prodhon luftë për liri. Fatkeqësisht qëndron në faktin që pushtuesit nuk kanë dëshirë ta mbajnë parasysh këtë të vërtetë. Ata mendojnë se meqë e kanë pushtuar një komb, duhet të kenë edhe qetësi e duhet që të pushtuarit të rrinë urtë. Por kjo nuk ndodh kurrë e kjo nuk ka ndodhur as në

Kosovë. Nën pushtim nuk mund të ketë urtësi, përveç popujve e kombeve që kanë tendencë të shpërbëhen e të zhduken në histori. E kjo nuk mund të ndodhte as nuk do të ndodhë ndër shqiptarët, të cilët, megjithëse me luftë, e kanë sjellë kombin e tyre prej lashtësie deri në kohët moderne, janë të gatshëm që nëse u diktohet, ta bëjnë të njëjtën gjë edhe në të ardhmen, por kurrë mos të lejojnë e pranojnë asimilimin dhe zhdukjen për interesat e armiqve. Ushtria Çlirimtare e Kosovës erdhi në rrugën kombëtare si një ushtri e re, e cila me forcën goditëse do të arrinte të realizonte aspiratat për të cilat kanë luftuar breza të tërë. Ajo, duke iu përgjigjur thirrjeve të kohës, arriti t'i krijojë vetes një emër të madh, që përmbledhte në vetvete dëshirat kombëtare shqiptare, ambiciet e popullit shqiptar, aspiratat drejt së ardhmes kombëtare, e cila me veprimtarinë politike, ushtarake, kulturore, humanitare, miqësore dhe me besnikërinë e shfaqur, ka dhënë shembullin më të mirë para historisë botërore. Por, jo rrallë të gjitha këto janë kthyer në të kundërtën e asaj dëshirë të mirë, për një jetë normale dhe për një ecuri dinjitoze. Kjo realisht po ndodh edhe sot, kur në vend që të akuzojë, akuzohet. Dhe akuzohet pikërisht pse nuk ka bërë ato për të cilat ngrihen akuzat. Djemtë e Kosovës, me gjithë shtypjen, represionin, shfarosjen e shpërnguljen, asnjëherë nuk pushuan së menduari e së punuari për të organizuar atë forcë të armatosur, që do t'i duhej atdheut në një kohë të caktuar, kur pushtuesit do të tentonin asgjësimin e plotë të tij. Mjaft prej këtyre djemve u

kapën, u burgosën, u vranë, u zhdukën, e ka edhe prej atyre që edhe sot e kësaj dite nuk dihet se janë apo nuk janë gjallë, për të cilët "kujdesen" Dick Marty dhe Gjykata Speciale e krimeve të luftës së UÇK-së, veçse ua kanë vënë emrat serbë, si dhe i kanë lënë pa adresë, pa familje, pa ditë të lindjes e vend të lindjes etj. Por, me gjithë këtë gjenocid të paparë, me gjithë këtë frymë fashiste të serbëve, djemtë e Kosovës nuk u ndalën, nuk u trembën dhe nuk u ulën. Ata ecën rrugës së lirisë. Pra, edhe në këtë situatë, në asnjë çast luftëtarët e lirisë nuk pushuan së përgatituri për të dalë në fushën e mejdanit, prej ku do të merrte vlerë jeta, e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja. Natyrisht, kjo erdhi duke derdhur gjak, duke sakrifikuar jetët, por fitorja ishte e domosdoshme. U pa në tërë praktikën politike të Kosovës, se ishte e pamundshme të arrihej zgjidhje për t'i realizuar aspiratat kombëtare të lirisë dhe pavarësisë. Me gjithë përpjekjet për mirëkuptim me Serbinë, Kosova nuk arriti ta shohë hisen e diellit të saj. Gjithë përpjekjet politike për të arritur paqe dhe stabilitet, nga serbët e jugosllavët, e pse jo edhe nga fuqitë evropiane, u vlerësuan si një vetënjështrim dhe si një dëshirë për t'u sunduar. Ata nuk u panë në asnjë rast si elementë të qytetarisë së kohës moderne. Nisur nga kjo gjendje dhe nga këto mendësi, ishte e pakuptueshme pritja. Po të niseshe në të gjitha drejtimet në kërkim të lirisë dhe të pavarësisë, rruga do të nxirrte në një pikë të lufta e armatosur pa kompromis, pa mëdyshje, edhe për ta fituar lirinë dhe për të shpëtuar një komb nga asimilimi. (Vijon)





Tru apo këpucë për shqiptarët?

Nga: Maximilian LAMBERTZ (Pjesë nga libri "Midis Drinit e Vjosës")

Zoti, kur krijoi njeriun, kishte për të gjithë njerëzit së bashku, duke filluar nga babai Adam deri tek njeriu i fundit, për të gjithë brezat, vetëm 300 gramë apo drihem tru. Nuk kishte më shumë se kaq për t'ua shpërndarë të gjithëve. Po si mund të mbusheshin me kaq pak tru kokat e gjithë njerëzve të botës? Ndoshta s'ishte e mundur! Se ka ca kokëgdhe që as gjashtë okë tru nuk do t'u dilnin. Pa le pastaj të mendosh 300 drihem që duhej t'u shpërndaheshin të gjithë njerëzve duke i takuar secilit vetëm një grimcë aq e vogël sa s'mund të mbushje as një gorricë. Prandaj njerëzit edhe kur plaken e kanë kokën bosh si kungull pa fara. Të gjithë e dinë se ne, të gjithë njerëzit në tokë, kemi nga një dërrasë mangët. Kjo do të thotë se të gjithë jemi pak të metë sipas mënyrës tonë. E po ky është problemi i çdonjërit!

Po kjo punë erdhi duke u keqësuar sepse sa më shumë shtoheshin njerëzit në tokë aq më pak

tru kishin. Po Zoti, i Plotfuqishmë, i cili, nga fronti ku mbretëron, sheh dhe ndjek fatin e gjithsecilit, vendosi ta ndryshojë varfërinë shpirtërore të fëmijëve të Adamit që kishin kaq pak tru. Ndaj një ditë iu drejtua Shën Kollit:

– Duke parë botën këtej nga lart çuditëm që njerëzit ende s'e kanë nxënë se janë vëllezër të një toke dhe se nuk është mirë t'i çajnë kokën njeri-tjetrit. Dhe me sa kuptoj unë shkak për këtë është se u kam dhënë shumë pak tru. Ndaj ngarko një anije me tru. Zbrit poshtë në tokë dhe shitua atyre që duan të blejnë. Vetëm bëj kujdes që t'ua shesësh aq shtrenjtë saç shet i biri të ëmën në pazar se mendja është më e shtrenjtë se bagëtia!

Shën Kolli, bekuar qoftë, s' priti dhe s'nguroi gjatë, po ngarkoi një anije me tru, shkoi gjithandej dhe te të gjithë kombet për të shitur tru dhe mendje. Shiti sa shiti dhe më në fund rruga i ra nga Shëngjini. S'kishte hedhur ende mirë spirancën, kur sheh një anije tjetër që po vinte nga Franca. Ishte djalli që kishte zbritur në tokë për të shitur këpucë.

U hap lajmi si rrufeja në të gjithë Shqipërinë se në Shëngjin kishin zbarkuar dy anije: një me këpucë

të vjetra dhe një tjetër me tru. Na u mblodhën shqiptarët në kuvend për t'u këshilluar. E morën fjalën të gjithë njëri pas tjetrit dhe më në fund vendosën: Shqipëria kishte nevojë për këpucë dhe jo për tru. Ndaj thanë se kush do blinte tru nga Shën Kolli jo vetëm që do mallkohej, por do të gjobitej duke i marrë dash e lopë.

Pastaj dërguan haber në Shëngjin për të pyetur djallin sa bënte barra e tij me këpucë. Djalli, kjo kuçedër e vjetër, që s'donte gjë tjetër veç të linte mallin e tij në Shqipëri, ua shiti shqiptarëve të gjithë barrën me këpucë me kredi. Dhe për t'u treguar edhe më bujar u tha se nuk donte që t'ia paguanin mallin po atë ditë dhe se nuk u vinte ndonjë afat të caktuar kur t'ia kthenin borxhin. U tha se do ta paguanin njëherë, po kush e di se kur. Kështu çdo shqiptar ra në borxh tek djalli.

Dhe që nga ajo ditë të parët tanë ecnin me këpucët e djallit në këmbë. Po nuk iu doli keq, aspak keq, për at Zot në qiell! Se s'ka thënë kot një plak i moçëm njëherë: "Kush s'ka kokë, ka këmbë!"

Shqiptarët nuk e çmojnë mendjen dhe trutë sepse janë betuar të mos blejnë kurrë!

NAKDOMONICIPEDIJA

Nga: Gjergj Fishta (Anzat e Parnasit, 1907)

PJESË E PARË

Ti me gjasë, Nakdo Monici (1),
S'din si hecë n'ketë jetë "cicnici".
Qysh se ty mund t'a hajë palla
Se po kape m'breg me pralla:
Due me thanë, tue vu mbi letra,
Kinse t'njohë fara e Shqyptarvet,
Si pat kenë besa e të Parvet!
Eh! zotni, t'ngjatët Zoti jetën!
Pa shikjoe'i herë kuletën,
E ajo ty ka me t'kallxue
Se shka t'zit ti kë fitue
Me n'jatë t'bukren Histori,
Qi ke shkruë përmbi Shqyptari:
Asë, idhnim pa fe nevoje,
E ndo'i borxh edhe n'shtypshkro-
je?...

Sod n'Shqyptari, more lum miku,
Histori asht metelikuj
Pse per tjetër, per ketë besë,
Veç se i qet ti zavall kresë,
Veç se i lan ti kryet gomarit,
Tu u mundue per fis t'Shqyptarit,
Paj Shqyptarët, si jem'tue pa,
Sod me sod s'janë tue pasë nga
Me u hutue me shkrime t'ona,
T'cillat s'pjellin napoljona,
As nuk bahen, besa, shkallë
Per me u n'jitë ku bahet pallë:
Punë qi lypën sod nder në,
Per me u rrekun per atdhë,
Ktu, zotni, t'ngjatët Zoti jetën!
Per pa e luejtë pak gjë kuletën,
S'çilet shtek as bahet kangë,
Pse e kanë xanë Shqyptarët atë
kangë:

Haja qenit – pija qenit,
Edhe bjer karaduzenit!...
Prandej sod letrarët e shkretë

Poshtë – n'fund t'unve – i lanë
pështetë,
Me'i grusht miza në kuletë,
E, hae i keq, kurrkush s'i pvetë
As per osh! – as per balosh!
Kush pat kenun si Allighieri?
E pra n'shekull, thonë, i mjeri
E pat punën rrokopujë,
Tu'u rropatun nper dhë t'hujë
Me Divinen Komedi
Si Per Curri nper Mal t'Zi:
Jo ma na qi i shkojm per nget
Sa prej Vrakët der n'Shkorret!...
E ma teper jem'Shqyptarë,
Qi, per t'urtë e per letrarë,
Kurr n'Shqyptari s'mund t'çojm kan-
darë.

Po e sheh vetë, Zotni, se kokrra
Nuk mund t'lidhim veç me dokrra (2);
Se me shkrie – e sterhollime
S'mund t'i a mbushim menden kujë,
Veç kot qesim petlla n'ujë...
Po, a thue e din, mor t'u ngjatët jeta!
Persë libra edhe gazeta,
E pse istore – e kangë arbnore
Sod me sod nder zogi t'Shqyptarit
S'janë tue pasun kurrfarë zarit?
N'mos e dijs, due me t'kallxue,
Per n'paç ngae ti me m'ndigjue.
Zoti i lum per njerzit mbarë,
Tue xanë fill m'babën e parë
E der m't'mbramin – rend e rend,
Veç treqind derhema mend
Se ma teper s'u pat da.
Me kaq mend, tash, more vlla,
A mund t'mbushen sa e sa koka
Qi per randë, ndoshta, i ka toka?
Besa, jo; pse edh'asht ndo'i koke
S'cillës s't'i dalin as gjashtë okë,
Jo se ma treqind derhëm
Qi janë dhanë per njerzit xhem (3),
Shka po u del nji pjesë e vogel,
Qi s'mbaston me mbushë nji
gogell!...

Prandej gjindja edhe si t'plaken
Disi golle e kanë rradaken,
Si me thanë, po e thom'per gjasë,

Si me thanë një kungull hasë.
Per këtë punë, po e sheh ti vetë,
Se, sa njerz jemi n'ketë jetë,
N'hatlla t'truvet te kaptina
Ka'i drrasë mëngut t'gjith e kina:
Due me thanë, kem'zi urtije,
Pse e kem'z'gjith ka'i rrem marrije.
Por ktu vetë s'po due me u djerrë,
Hollë e gjatë tue dashtë m'e tjerë
Sa marri qi ban gjithkush;
Veç seicilli t'vejë m'rabush
Punët e veta, e ka me pa
Se, perzët, fort i a kam gja.
Paj me kenë na bash mirë n'krye,
S'kjem tue pa seri me sye
Ke na shkojn punët kambë e krye...
Bre, e'ma zi kjen punët tue shkue,
Pse kto mend vijn tu'u pakue,
Kah vijn krenat tuj u shtue;
Por Njaj i lum, qi prej Empirit
Sheh e një tanë punët e nierit,
Aj mend-lehtit t'bijt e Adamit
Me i ndihmue desht n'ketë rod
skamit,
Prandë'i thotë një ditë Shen Nkollit:
"Tue kundruie un prej ktij trollit
Si hecë puna e mruzullimit
Po baj; seri prej njerzimit
Ke s'u bini një herë n'kokë
Se ata vllazen janë mbi toke,
E se s'asht fort punë e lmut
Shoqi shoqit m'i a xjerrë trut,
Un kujtoj, s'asht tjetër send
Qi s'u xehet vendi vend,
Veç pse u dava vetë pak mend.
Prandëj ulu tash mbi dhe,
E me mend ngarko'i gale:
Del tue shitë kush t'duen me ble.
Por këtë fjalë po t'tham ma t'mbra-
men:
Kë me shitë sa i biri t'amën,
Pse bajn mendt – ma shum se
dhent."
I Shën Nkollit, kjoftë levdue!
S'ndej atbotë tuj u hutue;
Por ngarkoi një barkë me mend,
Edhë duel aj per gjith vend,
Per gjith vend e per gjith fise.
Tue shitë mend e tue shitë shise,
Shiti i lumi mend sa shiti,
N'e mbramt udha n'Sh'Njin e qiti.
Por sa i uli n'det spirancet,
Qe'i barkë tjetër vjen prej Francet:
Kisht'dalë Djalli me'i gale
Me shitë shkarpa neper dhe.
U dha zani n'Shqyptari
Se dy barkë n'atë Sh'Njin kanë hi:
Njana mbushë me shkarpa t'vjetra,
Me mend t'holla mbushun tjetra.
Ran Shqyptarët, at-herë, n'kuvend,
E tue folun rend-e-rend (4) ,
E pleqnuen se per këtë vend
Duhet shkarpa e jo mend.
E prandëj kta bane toben,
E ma tepër vune gjoben
Per me u la me desh e qe,
Mend Shen Nkollit mos me i ble.
Mandëj çuen n'Sh'Njin ke djalli:
Per m'e pvetë sa i bate malli.

Edhe Djalli – dreq i vjetër,
Qi tue dashtë nuk ishte tjetër
Veç m'e lanë atë mall n'Shqyptari,
U a la shkarpat veresi
Per me dajë por ma bujar,
S'desht atë ditë me u dhanë pazar,
As s'desht vade me ju da,
Veç se u tha se kisht me u la
Gja – ç'do gja, kushdi se kur
Tue lanë mbrapa ka'i kusur.
Kshtu u tha Djallit, e atje ma vonë,
Mbathne shkarpat babat t'onë.
E s'banë keq, jo, per Tynzonë;
Pse pat thanë një plak pa dhambë:
Kush s'ka mend do t'ketë kambë,
A e din tash, o lum zotnija,
Pse s'kanë zari kangët e mija
Me sa t'ka ty Historija?
Paj Shqyptarët, t'thaçë, kanë ba be
Mend e shise mos me ble...
Pra, zotni, a e din shka ban?
Hidhi librat mbi tavan,
Edhe ri mandej pështetë
Me duer kryq, me sy përpjetë,
Tue njëhë miza – pëmbi lpiza;
Pse m'a thotë pors shum kujë,
Ka me t'hecë kunglli mbi ujë,
Ka me t'vu ty barku peta,
Kanë me t'ba t'gjith t'u ngjatët jeta!
E ti, i lmuet si një member,
Tuj u shkarrafendë m'minder,
– Kurr me punë, gjithmonë pa nga –
Gjyqin shokve ke m'u a da.
Sa me istore e Skanderbeg.,
Per këtë besë, s'ke me u kapë
m'breg,
As kurr ty s'ka me t'hecë zari:
Ka me t'mbetë nen bark samari;
Pse nder në kjo kohë ka ardhë,
Qi një e zezë me u thirrë e bardhë:
N'emem t'vet sendet s'duen qijtë
Per n'don qyqja mos me t'mujtë
E me t'fry era n'kuletë,
Por me t'shkue tymi përpjetë
Edhë fyellit me i ra pshtetë.
Po, por shka, letrarve t'ngratë
U a ka lanë lija zanatë
Me i thirrë sendet t'gjitha me emen,
Mashklin, mashkull – femnën,
femën:
E prandëj kanë shatin n'ujë
E u shkon puna rrokopujë.
Por, pse vetë due t'mirën, t'ande,
E ma tepër pse m'a kande
Qi t't'nderojë Roma e Stamolla,
Po t'i çoj do kshille. t'holla
Qi Tartufi (5) i ka pasë shkruie,
Per me dijtë si me jetue,
Per me dijtë si me vozitë
Nper tallaze t'shekllit t'ndritë,
Per n'do shndosh me dalun n'va
E n'do n'mjaltë spata me t'ra.
(1) Nakdomonici; Dom Ndoc Nikaj
(2) (Dokrra thirren kah Shqyptarija.
Dija, Kanga e Historija...)
(3) Ka'i fjalë turqë ban lazem.
(4) Shka nder në nuk mbahet mend.
(5) Mollere ka shkruie një Komedij
mbi Tartufin. /Telegrafi/

Koronavirusi anulon ceremoninë e ndarjes së çmimeve Nobel

Fondacioni Nobel, i cili administron ndarjen e çmimeve prestigjioze Nobel, thotë se për shkak të pandemisë koronavirusit, ka anuluar ceremoninë tradicionale, që mbahet çdo vit në muajin dhjetor, në Sallën e qytetit të Stokholmit.

Lars Heikensten, drejtori i përgjithshëm i Fondacionit Nobel, tha se për shkak të masave të kufizimeve, nuk është e mundur të mbledhen deri në 1.300 mysafirë.

Ai tha se për shkak të pandemisë është e pasigurt nëse fituesit e çmimeve do të mund të udhëtojnë në Suedi, raporton AP.

Fituesit shpallen në tetor, por fondacioni tha se nuk ishte plotësisht e qartë ende se si dhe



në çfarë forme do të zhvillohet ceremonia e ndarjes së çmimeve.

"Java e Nobelit nuk do të jetë si zakonisht për shkak të pandemisë aktuale. Ky është një vit shumë i veçantë kur të gjithë

duhet të bëjnë sakrificë dhe t'u përshtaten rrethanave plotësisht të reja, por ne do t'u kushtojmë vëmendje të ndryshme fituesve të çmimeve, zbulimeve dhe veprave të tyre", tha Heikensten në një deklaratë.

Agjentët e njohur britanikë, që vepruan në Shqipëri



Në librin "Sekretet e luftës", tregohen historitë e disa agjentëve britanikë që vepruan në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe që ndikuan në zhvillimet e mëvonshme. Më poshtë janë historitë e disa prej tyre.

Anthony Quayle (në foto, i pari djathtas) jetoi për një vit në Dukat të Vlorës. Pas luftës do të kthehet në një nga aktorët e njohur të Hollivudit. Shqiptarët e njohin kryesisht për rolin e tij në filmin "Lorenci i Arabisë". Kujtimet e tij mbi aventurën shqiptare të botuara në 1948, janë ende të papërkthyer në shqip.

Alan Hare, ende pa mbushur

25 vjeç, luftoi dhe punoi për një vit në Shqipëri. Në kushte të vështira, rrezikoi jetën disa herë dhe kujton që u detyrua të vriste mushkën për të ushqyer grupin e luftëtarëve gjatë dimrit të egër 1943-1944. Hare do bëhet një nga drejtuesit më të njohur të shërbimeve sekrete britanike MI6, pas luftime. Në vitet 1960, do shkëputet prej tyre, për të nisur një karrierë si një ndër menaxherët më të njohur në fushën e medias.


Bill Tillman, një nga eksploratorët më të njohur të shekullit XX, jetoi një vit në malet e jugut të Shqipërisë, kryesisht në fshatin Sheper të

Gjirokastrës. Sot shkolla e fshatit mban emrin e tij.

Majori Tony Simcox ishte i atashuar në grupin e Kryezinjve, luftoi bashkë me ta për çlirimin e Gjakovës nga gjermanët, ku dhe u plagos, por u arrestua nga partizanët bashkë me Said Kryeziun.

Julian Amery qëndroi për disa muaj në shtabin e Abaz Kupit, në vitin 1944. Djallë i një familjeje aristokrate dhe me traditë në politikë, do të bëhej një nga zërat e spikatur të konservatorëve të pasluftës. Ishte disa herë deputet dhe ministër, ndërsa u martua me vajzën e kryeministrit britanik, Harold Macmillan.





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Gjilani ndahet baras me Ballkanin, **Drita** shpallet kampione

Drita nga Gjilani është shpallur kampione e Superligës për herë të tretë në historinë e saj. Deri te ky sukses Drita erdhi pasi ndeshja derbi në mes të Gjilanit dhe Ballkanit u mbyll me rezultat 2-0. E paqartë mbetet gara për mbijetesë, pasi tash në pozitën që e dërgon në Ligën e Parë pozicionohet Drenica, me pikë të barabarta me Trepçën '89



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 22 KORRIK - Skuadra e Dritës është shpallur kampione e IPKO Superligës së Kosovës në futboll pasi ndeshja derbi e zhvilluar të mërkurën në mes të Gjilanit dhe Ballkanit ka përfunduar me rezultat 2-2. Ndeshja e zhvilluar në Gjilan ishte mjaft dramatike, kurse në fund skuadrat kanë ndarë pikët. Dy minuta para fundit të pjesës së parë Gjilani kaloi në epërsi me golin e Kushtrim Shabanit. Në pjesën e dytë mysafirët ishin më të mirë se vendësit dhe brenda tre minutave shënuan dy gola me anë të Mirlind Dakut dhe Jetmir Topalli për rezultatin 1-2.

Në minutat shtesë Keita Razak realizoi golin e barazimit (2-2). Pas kësaj ndeshje Gjilani e ka siguruar pozitën e dytë me 66 pikë, kurse Ballkani mbetet në pozitën e tretë

me 63 pikë. Fitore bindëse në derbin e skuadrave nga kryeqyteti ka shënuar Prishtina ndaj Flamurtarit (3-0). Pjesa e parë e ndeshjes që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri" përfundoi 0-0, kurse në dyzet e pesë minutat e dytë Prishtina shënoi tri gola.

Donat Vitia ka shënuar autogol, kurse dy golat e tjerë i kanë realizuar Meriton Korenica dhe Kreshnik Uka. Tri pikë të rëndësishme për mbijetesë ka marrë skuadra e Trepçës '89, e cila e ka mposhtur Feronikelin (1-2) në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. Për vendësit shënues në pjesën e parë ishte Gbowea Harmon, kurse për mysafirët në pjesën e dytë realizuan Lassine Traore dhe Robert Rrahmani.

Fitore në xhiron e parafundit shënoi Llapi ndaj Ferizajt (2-1). Me rezultat 2-1 fitore shënoi edhe Dukagjini ndaj Vushtrrisë.

IPKO Superligë

| | |
|-------------------------|-----|
| Gjilani - Ballkani | 2-2 |
| Prishtina - Flamurtari | 3-0 |
| Feronikeli - Trepça '89 | 1-2 |
| Llapi - Ferizaj | 2-1 |
| Dukagjini - Vushtrria | 2-1 |
| Drita - Drenica | 1-0 |

Në xhiron e fundit takohen:

| |
|------------------------|
| Drenica - Dukagjini |
| Vushtrria - Llapi |
| Ferizaj - Ferizaj |
| Trepça '89 - Prishtina |
| Flamurtari - Gjilani |
| Ballkani - Drita |

TABELA

| | | |
|---------------|----|---------|
| 1. Drita | 32 | 68 pikë |
| 2. Gjilani | 32 | 65 |
| 3. Ballkani | 32 | 64 |
| 4. Prishtina | 32 | 62 |
| 5. Llapi | 32 | 45 |
| 6. Feronikeli | 32 | 44 |
| 7. Flamurtari | 32 | 43 |
| 8. Trepça '89 | 32 | 41 |
| 9. Drenica | 32 | 41 |
| 10. Ferizaj | 32 | 29 |
| 11. Dukagjini | 32 | 19 |
| 12. Vushtrria | 32 | 18 |

SHKURT

FSUK-ja nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Federatën e Boullingut

Federata e Sporteve Universitare e Kosovës dhe Federata e Boullingut e Kosovës kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Presidenti i FSUNK-së, Musa Selimi dhe ai i FBOUK-së, Gani Pajaziti, kanë nënshkruar protokollin e bashkëpunimit. "Qëllimi i kësaj marrëveshje është organizimi i përbashkët i turneve të ndryshëm, liga universitare, garat ndërkombëtare etj", thuhet në njoftimin e FSUK-së.

Ndeshja Veteranët - Estrada në shënim të ditëlindjes së Vokrrit

Sot (e enjte) për nder të ditëlindjes së legjendës së futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri, i cili ka ndërruar jetë dy vjet më parë, nën organizim të Federatës së Futbollit të Kosovës, Ligës së Veteranëve dhe grupit të tifozëve "Dardanët", do të zhvillohet ndeshja revyale ndërmjet ekipit të Veteranëve dhe ekipit të Estradës. Ndeshja do të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në orën 19:00. Për shkak të situatës së pandemisë, ndeshja zhvillohet pa praninë e tifozëve. Grumbullimi i të ftuarve në këtë ndeshje fillon në orën 18:00.

Ajeti mund të përfundojë në Celtic

Celtic Glasgow duket se ia ka vënë syrin Alban Ajetit të West Ham Unitedit, sipas raportimeve nga "Sky Sports". Neil Lennon ka qenë shumë i përfshirë në bisedime me klubin nga Premierë Liga, teksa klubi i tij po synon që të bëjë një ofertë formale këtë verë. Gjelbër e Bardhët janë të hapur që ta transferojnë Ajetin, qoftë në mënyrë permanente apo në formë huazimi, teksa vlera e tij në treg vlerësohet se është tetë milionë funte.

Mustafa ndahet me Dukagjinin

